



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITI OF LIPJAN

Datë	21/11/2018
Referencë	
Për:	Për NPSH AFA ING, dhe Të gjitha palët e interesuara
Nga	z. Adem Duriqi, drejtor-Drejtorisë së Prokurimit
Lënda:	Shqyrim i ankeses nga O.E.



Duke u bazuar në 108 / A të ligjit nr.04 / L-042 për prokurim Publik të Republikës së Kosovës, ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, zyrtari përgjegjës i prokurimit duke vendosur në bazë të kërkesë për rishqyrtim të Operatorit ekonomik (OE) **“NPSH AFA ING” nga Suhareka** pjesëmarrës në tenderin **“Furnizimi me pajisje për sistemim të radhëve”** me nr. të Prokurimit 613 18 034 136 Autoritetin Kontraktues, respektivisht zyrtari Përgjegjës i Prokurimit nxjerr këtë ;

VENDIM

Refuzohet kërkesa për rishqyrtim e propozuar për shqyrtim si e pabaze, e Operatorit Ekonomik **“NPSH AFA ING” nga Suhareka** pjesëmarrës në tenderin **“Furnizimi me pajisje për sistemim të radhëve”** me nr. të Prokurimit 613 18 034 136

RAPORTI I ZYRTARIT PËRGJEGJËS TË PROKURIMIT

	19/11/2018	21/11/2018	21/11/2018
Nënshkrimi i Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit	Data e pranimit të kërkesës për shqyrtim	Data e fillimit të shqyrtimit të kërkesës	Data e dorëzimit të OE” “NPSH AFA ING” nga Suhareka

Neni 108/A zgjedhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Me datë 19/11/2018 AK Komuna Lipjan ka pranuar kërkesën për rishqyrtim përmes e-mail adreses nga “NPSH AFA ING” nga Suhareka Pjesëmarrës në tenderin “Furnizimi me pajisje për sistemim të radhëve” me nr. të Prokurimit 613 18 034 136 iniciuar nga (AK – Komuna e Lipjanit) – Zyra e Prokurimit.

Konform Nenit 108/A pika 6 të LPP dhe konform kërkesës në formë elektronike të datës 19/11/2018 komisioni i formuar nga zyrtari përgjegjës i prokurimit i cili ka shqyrtuar dhe analizuar “Furnizimi me pajisje për sistemim të radhëve” me nr. të Prokurimit 613 18 034 136

Pikat e ankesës nga “NPSH AFA ING” nga Suhareka dispozitat e shkelura nga AK; shkelje e ligjit të Prokurimit Publik.

- Neni: 1, Neni: 6, Neni: 7, Neni: 56.3, Neni: 59, Neni: 60, Neni: 116.6

Deklarat totale mbi faktet dhe argumentet:

- Kemi pranuar letren standarde për tenderusin e eliminuar për pikat

Conform nenit 108 të LPP-se parashtrojmë këto ankesë në OSHP, dhe ne vijim të argumentojmë shkeljet e dispozitave të LPP-se, e në veçanti nenit 56.3 dhe 116.6 të LPP-se, nga autoriteti kontaktues Komuna e Lipjanit.

Duke ju referuar letres standarde, keni deklaruar se “Bazuar në vendimin e OSHP-se oferta juaj është eliminuar sepse keni bashkëngjitur katalogje që nuk janë në përputhje me specifikat teknike të dosjes së tenderit”, mbarim citati.

Arsyetimi i lartepërmendur në letren standarde, nuk qëndron për faktin se në nenin 116.6 të LPP-se thuhet: Një vendim i OSHP-së për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar.

Prandaj, ne konstatojmë se ju si autoritet kontaktues keni bërë shkelje të këtij neni sepse vendimin në të cilin bazoheni ju nuk nënkupton një ndryshim nga rezultati fillestar dhe atëherë keni bërë shkelje të nenit 56.3 të LPP-se sepse katalogun të cilin e keni cekur NUK EKZISTON SI KERKESE E DOSJES SE TENDERIT, andaj vlerësimi i një oferte dhe eliminimi i saj për një kërkesë e cila nuk ekziston e cila përben shkelje të hapur të nenit 56.3 të LPP-se, në të cilin thuhet: Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociatë, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Sqarim: menyra se si e keni argumentuar eliminimin tone ne letren standard nuk ju largon nga pergjegjsia sepse nenit 116.6 i LPP-se i lartcituara e thot te kunderten.

Andaj, ne baze te ketyre fakteve dhe argumenteve te lartcituara kerkojme qe kerkesa per rishqyrtim te aprovohet dhe ky aktivitet i prokurimit te kthehet ne rivleresim dhe vlerseimi i ofertave te behet ne perputhje te plot me nenin 56.3 te LPP-se dhe nenin 59 te LPP-se.

Deme material:

Kompania jone demtohet per 2500 euro

Procesi i prokurimit :

Data e njoftimit për kontratë	08/05/2018
Lloji i procedurës se aplikuar	kuotim i qmimit
Lloji dhe vlera e kontratës se aplikuar.....	furnizim/montim
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave	15/05/2018
Data e hapjes se ofertave	15/05/2018
Data e njoftimit për dhënie te kontratës ne Web faqen e KRPP-se.....	04/11/2018

Rexhistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike.

1	N.P.SH. "AFA-ING"	6.765,00
2	"PBC SH.P.K."	6.785.50

Pas egzaminimit dhe vlersimit te tenderve si OE te suksesshem mbesin keta OE

1	"PBC SH.P.K."	6.785.50
---	---------------	----------

Analizat dhe sqarimet e zyrtarit Pergjegjes te Prokurimit.

Komisioni për rivlerësimin e ofertave është bazuar në vendimin e nxjerrë nga ana e OSHP-së, se oferta e juaj ka të bashkangjitur katalogje që nuk janë në përputhje me specifikimet teknike

Komisioni i rivlerësimit duke u bazuar ne ligjet e LPP dhe vendimit te OSHP rekomandon si OE te sukseshem OE "PBC SH.P.K.",Prishtinë

Ky është rekomandimi i komisionit vlerësues për dhënie te kontratës.

Komisioni punën përfundon me date : 14/11/2018

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit bazuar në sqarimet e cekura në raport mendon që AK për aktivitetin e Prokurimit "Furnizimi me pajisje për sistemim të radhëve" me nr. të Prokurimit 613 18 034 136, ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-se në fuqi

Gjithashtu zyrtari përgjegjës i Prokurimit ankesën e OE N.P.SH. "AFA-ING" nga Suhareka e konsideron të pabazë.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit nga provat e prezantuara me lartë vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Këshilla Juridike:

Kundër këtij Vendimi Pala e pakënaqur me ankesë mund të drejtohet OSHP-se sipas Ligjeve në fuqi

Lipjan

Më datë: 21/11/2018

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit i AK



Adem Duriqi